7.5 Drita e treguesit të temperaturës .....	41		

sq

**16 Të dhëna teknike..... 51**



## 1 Siguria

Mbani parasysh udhëzimet e sigurisë në vijim.

### 1.1 Udhëzime të përgjithshme

- Lexoni me kujdes këtë manual.
- Ruani manualin dhe informacionet e produktit për përdorim të mëvonshëm ose për zotëruesin pasardhës të saj.
- Mos e lidhni pajisjen nëse konstatooni dëmtime nga transporti.

### 1.2 Përdorimi i parashikuar

Përdoreni pajisjen vetëm:

- për të ngrirë ushqimin dhe për të përgatitur akull në kuba.
- për qëllime private familjare dhe në ambiente të mbyllura brenda shtëpisë.
- deri në një lartësi prej 2000 m mbi nivelin e detit.

### 1.3 Kufizimi i rrethit të përdoruesve

Kjo pajisje mund të përdoret nga fëmijët e moshës 8 vjeç e lart dhe nga personat me aftësi të kufizuara fizike, ndijuese ose mendore apo me mungesë përvoja dhe/ose njohurish, nëse këta mbikëqyren ose udhëzohen për përdorimin e sigurt të pajisjes dhe ata i kuptojnë rreziqet që mund të lindin prej saj.

Mos lejoni fëmijët që të luajnë me pajisjen.

Pastrimi dhe mirëmbajtja nga përdoruesi nuk duhet të bëhen nga fëmijët pa mbikëqyrjen e një të rrituri.

### 1.4 Transporti i sigurt

#### **PARALAJMËRIM – Rrezik lëndimi!**

Pesha e madhe e pajisjes mund të shkaktojë lëndime gjatë ngritjes së saj.

- ▶ Mos e ngrini kurrë vetëm pajisjen.



## 1.5 Instalimi i sigurt

### **⚠ PARALAJMËRIM – Rrezik nga goditja elektrike!**

Instalimet e parregullta janë të rrezikshme.

- ▶ Lidheni pajisjen dhe vëreni në përdorim vetëm në rrjet elektrik sipas të dhënave në etiketën e parametrave.
- ▶ Lidheni pajisjen vetëm nëpërmjet një prize të instaluar sipas rregullave me tokëzim, në një rrjet elektrik me rrymë alternative.
- ▶ Sistemi mbrojtës i instalimit elektrik të shtëpisë duhet të jetë instaluar sipas rregullave.
- ▶ Asnjëherë mos e ushqeni pajisjen përmes një aparature të jashtme vepruese, si p.sh. kohëmatës ose telekomandim.
- ▶ Kur pajisja është e montuar inkaso, spina e kordoni elektrik duhet të jetë lehtësisht e arritshme ose kur aksesimi i saj nuk është i mundur, në instalimin e përcaktuar elektrik duhet të jetë instaluar një çelës ndarës shumëpolësh, sipas dispozitave të ndërtimit.
- ▶ Gjatë instalimit të pajisjes bëni kujdes që kordoni elektrik të mos ngecet ose që të mos dëmtohet.

Izolimi i dëmtuar i kordonit elektrik përbën rrezik për jetën.

- ▶ Mos e vini kurrë në kontakt linjën elektrike me burimet e nxehtësisë.

### **⚠ PARALAJMËRIM – Rrezik shpërthimi!**

Kur vrimat e ventilimit të pajisjes janë të bllokuara, në rast rrjedhjeje të qarkut të ftohjes mund të krijohet një përzierje gaz-ajër që merr flakë.

- ▶ Mos i bllokoni vrimat e ventilimit në trupin e pajisjes ose në skeletin e montimit inkaso.

### **⚠ PARALAJMËRIM – Rrezik zjarri!**

Përdorimi i një kordoni zgjatues elektrik dhe i përshtatësve të pamiratuara është i rrezikshëm.

- ▶ Mos përdorni kablllo zgjatuese ose prizë bashkuese me shumë vende.
- ▶ Përdorni vetëm adaptorë dhe linja elektrike të miratuara nga prodhuesi.

- ▶ Nëse kordoni elektrik është shumë i shkurtës dhe nuk keni kordon më të gjatë, kontaktoni me një elektrikist të specializuar për të rregulluar instalimin e shtëpisë.

Prizat zgjatuese portative me shumë fole ose pjesët e rrjetit elektrik në terren mund të mbinxehen dhe të shkaktojnë zjarr.

- ▶ Mos i vendosni prizat zgjatuese portative me shumë fole ose pjesët e rrjetit elektrik në anën e pasme të pajisjes.

## 1.6 Përdorimi i sigurt

### **⚠ PARALAJMËRIM – Rrezik nga goditja elektrike!**

Lagështia që futet brenda mund të shkaktojë goditje elektrike.

- ▶ Përdoreni pajisjen vetëm në ambiente të mbyllura.
- ▶ Asnjëherë mos e ekspozoni pajisjen në nxehtësi të madhe apo në lagështi.
- ▶ Mos përdorni pastrues me avull ose pastrues me presion të lartë për të pastruar pajisjen.

### **⚠ PARALAJMËRIM – Rrezik asfiksimi!**

Fëmijët mund të fusin në kokë ose të mbështillen me materialin e paketimit dhe për rrjedhojë të mbyten.

- ▶ Mbani larg fëmijëve materialin e paketimit.
- ▶ Mos i lini fëmijët të luajnë me materialin e paketimit.

Fëmijët mund të thithin ose të gëlltitin pjesë të vogla dhe për rrjedhojë të mbyten.

- ▶ Mbani pjesët e vogla larg nga fëmijët.
- ▶ Mos lejoni fëmijët të luajnë me pjesët e vogla.

### **⚠ PARALAJMËRIM – Rrezik shpërthimi!**

Për shkak të dëmtimit të qarkut qarkullues të ftohjes, gazi ftohës i ndezshëm mund të rrjedhë jashtë dhe të shpërthejë.

- ▶ Mos përdorni asnjë pajisje tjetër mekanike ose ndonjë mënyrë tjetër, përveç atyre të rekomanduara nga prodhuesi, për të shpejtuar procesin e shkrirjes.
- ▶ Lironi ushqimet shumë të ngrira me një objekt me majë jo të mprehtë, për shembull me bisht luge druri.

Produktet me gaze shtytëse të djegshme dhe lëndët eksplozive mund të shpërthejnë, p.sh. kanaçe për spërkatje.

- ▶ Mos mbani në pajisje asnjë produkt me gaze shtytëse të djegshme dhe asnjë lëndë eksplozive.

### **⚠ PARALAJMËRIM – Rrezik zjarri!**

Pajisjet elektrike në brendësi të pajisjes mund të shkaktojnë zjarr, si për shembull pajisjet ngrohëse ose pajisjet elektrike për prodhimin e akullit.

- ▶ Mos përdorni asnjë pajisje tjetër elektrike në brendësi të pajisjes.

### **⚠ PARALAJMËRIM – Rrezik lëndimi!**

Shisheet e pijeve me përmbajtje acidi karbonik mund të shpërthejnë.

- ▶ Mos ruani asnjë shishe me pije që përmban acid karbonik në ndarjen e ngrirjes.

Lëndim i syve nga rrjedhja e gazit ftohës të djegshëm dhe gazeve të dëmshme.

- ▶ Mos dëmtoni izolimin dhe tubat e qarkut të freonit.

Pajisja mund të përmbysset.

- ▶ Mos shkelni mbi bazament, mbi pjesët e zgjatura ose mbi dyer ose mos u mbështetni tek to.

### **⚠ PARALAJMËRIM – Rrezik djegiesh!**

Pjesë të caktuara në faqen e pasme të pajisjes nxehen shumë gjatë funksionimit.

- ▶ Mos i prekni asnjëherë pjesët e nxehta.

### **⚠ PARALAJMËRIM – Rrezik djegiesh nga i ftohti!**

Kontakti me ushqimin e ngrirë dhe sipërfaqet e ftohta mund të shkaktojë djegie nga i ftohti.

- ▶ Asnjëherë mos e futni direkt në gojë ushqimin e ngrirë, menjëherë pasi është nxjerrë nga ndarja e ngrirjes.
- ▶ Shmangni kontaktin e gjatë të lëkurës me ushqimin e ngrirë, me akullin dhe me sipërfaqet e ndarjes së ngrirjes.

**⚠ KUJDES – Rrezik dëmsh në shëndet!**

Për të shmangur kontaminimin e ushqimeve duhen mbajtur parasysh udhëzimet më poshtë.

- ▶ Kur dera mbahet hapur për një kohë të gjatë, në ndarjet e pajisjes mund të ndodhë një rritje e konsiderueshme e temperaturës.
- ▶ Pastroni rregullisht sipërfaqet që janë kontakt me ushqimet dhe me sistemet e arritshme të shkarkimit.
- ▶ Kur frigoriferi ftohës/ngrirës qëndron bosh për një kohë gjatë, fikni pajisjen, shkrijeni atë, pastrojeni dhe lëreni derën hapur, në mënyrë që të shmangni formimin e mykut.

**1.7 Pajisja e dëmtuar****⚠ PARALAJMËRIM – Rrezik nga goditja elektrike!**

Pajisja e dëmtuar ose kordoni elektrik i dëmtuar përbëjnë rrezik për jetën.

- ▶ Kurrë mos vini në punë një pajisje të dëmtuar.
- ▶ Asnjëherë mos tërhiqni kordonin elektrik për të shkëputur pajisjen nga rrjeti elektrik. Hiqeni kordonin elektrik duke e kapur gjithmonë nga spina.
- ▶ Kur pajisja ose kordoni elektrik është i dëmtuar, shkëputni menjëherë kordonin elektrik ose fikni siguresën në kutinë e siguresave.
- ▶ Telefononi shërbimin e klientit. → *Faqe 51*

Riparimet e gabuara janë shkak për rreziqe.

- ▶ Riparimet në pajisje duhen kryer vetëm nga staf teknik i trajnuar për këtë qëllim.
- ▶ Për riparimin e pajisjes lejohet të përdoren vetëm pjesë këmbimi origjinale.
- ▶ Nëse dëmtohet kordoni elektrik i pajisjes, atëherë ai duhet të zëvendësohet nga prodhuesi ose shërbimi i tij për klientin ose nga një person i ngjashëm i kualifikuar, për të evituar rreziqet e mundshme.

 **PARALAJMËRIM – Rrezik zjarri!**



Nëse tubacionet dëmtohen, jashtë mund të rrjedhë agjenti ftohës i ndezshëm dhe gaze të dëmshme dhe ato mund të marrin flakë.

- ▶ Mbani larg nga pajisja burimet e zjarrit dhe të ndezjes.
- ▶ Ajrosni dhomën.
- ▶ Fikni pajisjen. → *Faqe 41*
- ▶ Hiqni spinën e kordonit elektrik ose fikni siguresën në kutinë e siguresave.
- ▶ Telefononi shërbimin e klientit. → *Faqe 51*

## 2 Shmangia e dëmeve materiale

### VINI RE!

Cepat e rrotave të pajisjes mund të dëmtojnë dyshemenë gjatë zhvendosjes së pajisjes.

- ▶ Transportojeni pajisjen me një karrocë dore.
- ▶ Për zhvendosjen e pajisjes përdorni një mbrojtëse për dyshemenë dhe mos e lëvizni në formë zig-zagu.

Përdorimi i bazamentit, i pjesëve të zgjatura ose i dyerve të pajisjes si sipërfaqe ulëse ose sipërfaqe mbështetëse mund të dëmtojë pajisjen.

- ▶ Mos shkelni mbi bazament, mbi pjesët e zgjatura ose mbi dyer ose mos u mbështetni tek to.

Për shkak të ndotjeve me vaj ose yndyrë, pjesët plastike dhe guarnicionet e dyerve mund të bëhen porozë.

- ▶ Mbani të pastra pa vaj dhe pa yndyrë pjesët plastike dhe guarnicionet e dyerve.

## 3 Mbrojtja e mjedisit dhe kursimi

### 3.1 Hedhja e paketimit

Materialet e paketimit janë ekologjike dhe të riciklueshme.

- ▶ Hidhni pjesët e caktuara të seleksionuara sipas llojit.

### 3.2 Kursimi i energjisë

Nëse i ndiqni këto udhëzime, pajisja juaj harxhon më pak energji elektrike.

#### Zgjedhja e vendit të instalimit

- Mbroni pajisjen nga drita e drejtpërdrejtë e diellit.
- Instaloni pajisjen mundësisht në distancë maksimale nga rezistenat ngrohëse, sobat dhe burimet e tjera të nxehtësisë:
  - Ruani një distancë 30 mm nga sobat elektrike ose me gaz.
  - Ruani një distancë 300 mm nga sobat me naftë ose me qymyr.
- Mos i mbuloni apo zhvendosni asnjëherë zgavrat e jashtme të ajrimit.

#### Kursimi i energjisë gjatë përdorimit

**Shënim** Organizimi i pjesëve të pajimit nuk ka asnjë ndikim në konsumin e energjisë së pajisjes.

- Hapni vetëm për pak kohë pajisjen dhe mbylleni me kujdes.
- Mos i mbuloni apo zhvendosni zgavrat e brendshme të ventilimit ose zgavrat e jashtme të ajrimit.
- Transportoni ushqimet e blera në një çantë termike dhe futini shpejt në pajisje.
- Lëri ushqimet dhe pijet e ngrohta që të ftohen, përpara se t'i futni në pajisje.
- Lini gjithmonë pak hapësirë të lirë midis ushqimit dhe faqes së pasme.

#### Modaliteti "Standby"

Kur pajisja nuk përdoret, ekrani kalon automatikisht në modalitetin "Standby" (në gatishmëri).

Në modalitetin "Standby" drita e panelit të komandimit reduktohet dhe treguesi i "Standby" ndizet.

**Shënim** Kur aktivizohet Super ngrirje, ndizet super.

Sapo ju përdorni ekranin ose hapni derën e pajisjes, modaliteti "Standby" çaktivizohet.

## 4 Instalimi dhe lidhja

### 4.1 Përmbajtja e paketimit

Pas nxjerrjes nga paketimi kontrolloni të gjitha pjesët për dëmtime nga transporti dhe për plotësinë e dërgesës.

Nëse keni ankesa, kontaktoni me shitësin ose drejtohuni te Shërbimi i klientit → *Faqe 51*.

Përmbajtja e dërgesës përbëhet nga:

- Pajisje e pavarur
- Pjesët e pajimit dhe aksesorët<sup>1</sup>
- Materiali i montimit
- Manuali i montimit
- Manuali i përdorimit
- Lista e qendrave të shërbimit të klientit
- Fletëpalosja e garancisë<sup>2</sup>
- Etiketat e energjisë
- Informacionet për konsumin e energjisë elektrike dhe për zhurmat

### 4.2 Kriteret për vendin e instalimit

#### **PARALAJMËRIM** **Rezic shpërthimi!**

Kur pajisja qëndron në një dhomë shumë të vogël, në rast rrjedhjeje të qarkut të ftohjes mund të krijohet një përzierje gaz-ajër që merr flakë.

- ▶ Instalojeni pajisjen vetëm në një dhomë që ka një vëllim të paktën 1 m<sup>3</sup> për çdo 8 g gaz ftohës. Sasia e gazit ftohës tregohet në etiketën e tipit. → *Fig. 1/6*

Pesha e pajisjes nga fabrika, në varësi të modelit, mund të jetë deri në 85 kg.

Për të mbajtur peshën e pajisjes duhet që bazamenti poshtë saj të jetë mjaftueshëm i qëndrueshëm.

#### **Temperatura e lejuar e dhomës**

Temperatura e lejuar e dhomës varet nga klasa klimatike e pajisjes. Klasa klimatike jepet në etiketën e tipit. → *Fig. 1/6*

Klasa klimatike	Temperatura e lejuar e dhomës
SN	10°C...32°C
N	16°C...32°C
ST	16°C...38°C
T	16°C...43°C

Pajisja është plotësisht funksionale brenda temperaturës së lejuar të dhomës.

Kur një pajisje e klasës klimatike SN vihet në punë në temperatura dhome më të ftohta, dëmtimet në pajisje mund të përjashtohen deri në një temperaturë dhome prej 5°C.

<sup>1</sup> Sipas pajimit të pajisjes

<sup>2</sup> Jo në të gjitha vendet

## Instalimi lart dhe poshtë dhe Side-by-Side

Kur dëshironi të instaloni 2 pajisje ftohëse sipër njëra-tjetrës ose në krah të njëra-tjetrës, duhet që midis pajisjeve të ruani një distancë minimumi 150 mm. Për pajisjet e zgjedhura është i mundur një instalim pa distancë minimale. Për këtë pyetni në dyqanin e specializuar ose arkitektin e kuzhinës.

### 4.3 Montimi i pajisjes

- ▶ Montoni pajisjen sipas manualit të montimit të ofruar me pajisjen.

### 4.4 Përgatitja e pajisjes për përdorimin e parë

1. Hiqni nga pajisja broshurat e informacioneve.
2. Hiqni fletët mbrojtëse dhe siguresat e transportit, p.sh. shiritat ngjitës dhe kartonët.
3. Pastroni pajisjen për herën e parë. → *Faqe 45*

### 4.5 Lidhja elektrike e pajisjes

1. Futni spinën e kordonit elektrik të pajisjes në prizën në afërsi të pajisjes.  
Të dhënat e lidhjes së pajisjes i gjeni tek etiketa e parametrave të tipit. → *Fig. 1/6*
  2. Kontrolloni spinën elektrike për qëndrimin e duhur.
- ✓ Tani pajisja është gati për punë.

## 5 Njohja

### 5.1 Pajisja

Këtu gjeni një pasqyrë përmbledhëse të pjesëve përbërëse të pajisjes.

→ *Fig. 1*

- |   |  |
|---|--|
| 1 | Paneli i komandimit → <i>Faqe 39</i>           |
| 2 | Çelësi kryesor                                 |
| 3 | Rafti i ndarjes së ngrirjes                    |
| 4 | Prodhuesi i kubave të akullit → <i>Faqe 40</i> |
| 5 | Koshi i ushqimeve të ngrira → <i>Faqe 45</i>   |
| 6 | Etiketa e tipit → <i>Faqe 51</i>               |
| 7 | Këmba me rregullim të lartësisë                |

**Shënim** Ekziston mundësia e ndryshimeve midis pajisjes suaj dhe figurave, për sa i përket pjesëve dhe madhësisë së tyre.

### 5.2 Paneli i komandimit

Përmes panelit të komandimit mund të caktoni të gjitha funksionet e pajisjes dhe të merrni informacion për gjendjen e funksionimit.

→ *Fig. 2*

- |   |   |
|---|---|
| 1 | Tregon temperaturën e vendosur në ndarjen e ngrirjes në °C.     |
| 2 | super ndizet, kur aktivizohet Super ngrirje.                    |
| 3 | alarm ndizet, kur aktivizohet alarmi.                           |
| 4 | Treguesi "Standby" ndizet kur është aktiv modaliteti "Standby". |



**5** -/+ vendos temperaturën e ndarjes së ngrirjes.

**6** super aktivizon ose çaktivizon Super ngrirje.

**7** alarm off fik sinjalin akustik paralajmërues.

## 6 Pjesët

Pajimi për pajisjen tuaj varet nga modeli i saj.

### 6.1 Prodhuesi i kubave të akullit

Përdoreni prodhuesin e kubave të akullit për të prodhuar akull nga uji i pijshëm.

#### Prodhimi i kubave të akullit

Përdorni vetëm ujë të pijshëm për prodhimin e kubave të akullit.

1. Hiqni kutinë e kubave të akullit ①, mbusheni në  $\frac{3}{4}$  me ujë të pijshëm ② dhe vendoseni sërish në vend ③

→ Fig. 3

**Shënim** Uji i tepërt mund të ndikojë në funksionimin e prodhuesit të kubave të akullit. Kubat e akullit nuk nxirren të veçuar nga forma e kubave të akullit. Uji i tepërt derdhet brenda në kosh dhe kubat ekzistues të akullit ngrijnë të ngjitur me njëri-tjetrin.

2. Kur kubat e akullit të kenë ngrirë, rrotulloni disa herë nga e djathta dorezën e kutisë së kubave të akullit dhe lëshojeni.

→ Fig. 4

- ✓ Kubat e akullit lëshohen dhe bien brenda koshit të kubave të akullit.

3. Nxirri jashtë koshin e akullit dhe merrni kubat e akullit.

→ Fig. 5

### 6.2 Aksesorët

Përdorni vetëm aksesorë origjinalë. Ata janë posaçërisht për pajisjen tuaj. Aksesorët për pajisjen tuaj varen nga modeli i saj.

#### Pllaka e ftohjes

Përdorni pllakën e ftohjes për të mbajtur përkohësisht të freskët të ushqimeve, për shembull në një çantë frigorifer.

**Këshillë** Në rast të ndërprerjes së energjisë elektrike ose të një defekti, pllaka e ftohjes e ngadalëson ngrohjen e ushqimeve të vendosura në ngrirje.

## 7 Përdorimi bazë

### 7.1 Ndezja e pajisjes

1. Ndizni pajisjen me anë të çelësit kryesor. → Fig. 1/2
  - ✓ Pajisja fillon të ftohë.
  - ✓ Tingëllon një sinjal paralajmërues dhe alarm ndizet, sepse ndarja e ngrirjes është akoma shumë e ngrohtë.
2. Fikni sinjalin paralajmërues me alarm off.
  - ✓ alarm fiket sapo arrihet temperatura e vendosur.
3. Vendosni temperaturën që dëshironi. → Faqe 41

### 7.2 Udhëzimet për përdorimin

- Pasi e keni ndezur pajisjen, mund të nevojiten shumë orë derisa pajisja të arrijë temperaturën e vendosur.

Mos futni asnjë ushqim në ruajtje përpara se të jetë arritur temperatura e vendosur.

- Façet ballore të trupit nxehen paksa përkohësisht. Kjo parandalon formimin e kondensimit në zonën e guarnicionit të derës.
- Kur mbyllni derën, mund të krijohet vakuum. Dera mund të hapet sërish vetëm me vështirësi. Pritni për një moment derisa të balancohet presioni negativ.

### 7.3 Fikja e pajisjes

- ▶ Fikni pajisjen me çelësin kryesor .  
→ Fig. 1/2

### 7.4 Vendosja e temperaturës

#### Vendosja e temperaturës në ndarjen e ngrirjes

- ▶ Shtypni  $-/+$  aq herë derisa treguesi i temperaturës të tregojë temperaturën që dëshironi.  
Temperatura e rekomanduar në ndarjen e ngrirjes është  $-18^{\circ}\text{C}$ .

### 7.5 Drita e treguesit të temperaturës

Ju mund ta fikni dritën e treguesit të temperaturës.

**Shënim** Edhe kur drita e ndriçuesit të temperaturës është e ndezur, niveli i dritës ulet në modalitetin "Standby".

#### Ndezja e dritës së treguesit të temperaturës

- ▶ Mbani shtypur alarm off për 5 sekonda derisa të tingëllojë një sinjal akustik.

### Fikja e dritës së treguesit të temperaturës

- ▶ Mbani shtypur alarm off për 5 sekonda derisa të tingëllojë një sinjal akustik.

## 8 Funksionet shtesë

### 8.1 Super ngrirje automatike

Në Super ngrirje automatike, ndarja e ngrirjes ftoh dukshëm më shumë sesa në funksionim normal. Si rezultat ushqimet ngrijnë më shpejt. Funksioni Super ngrirje automatike aktivizohet kur në koshin e dytë nga poshtë të ushqimeve të ngrira futni ushqim të freskët, duke filluar nga e djathta.

Kur aktivizohet Super ngrirje automatike, ndizet super dhe mund të krijohet nivel më i lartë zhurme. Pas përfundimit të Super ngrirje automatike pajisja rikthehet në funksionim normal.

#### Anulimi i Super ngrirje automatike

- ▶ Shtypni super.
- ✓ Tregohet temperatura e vendosur më parë.

### 8.2 Super ngrirje manuale

Në Super ngrirje ndarja e ngrirjes ftoh aq shumë sa është e mundur. Aktivizojeni Super ngrirje 4 deri në 6 orë orë përpara futjes së një sasive ushqimesh mbi 2 kg në ndarjen e ngrirjes.

Për të shfrytëzuar kapacitetin e ngrirjes, përdorni Super ngrirje.

→ "Kushtet paraprake për kapacitetin e ngrirjes", Faqe 43

**Shënim** Kur aktivizohet Super ngrirje, mund të ndodhë rritje e nivelit të zhurmës.

### **Aktivizimi i Super ngrirje manuale**

- ▶ Shtypni super.
- ✓ super ndriçon.

**Shënim** Pas rreth 60 orësh pajisja rikthehet në funksionim normal.

### **Çaktivizimi i Super ngrirje manuale**

- ▶ Shtypni super.
- ✓ Tregohet temperatura e vendosur më parë.

---

## **9 Alarmi**

### **9.1 Alarmi i derës**

Kur dera e pajisjes qëndron hapur për kohë të gjatë, ndizet alarmi i derës.

Tingëllon një sinjal paralajmërues dhe alarm ndizet.

#### **Fikja e alarmit të derës**

- ▶ Mbyllni derën e pajisjes ose shtypni alarm off.
- ✓ Sinjali paralajmërues fiket.

### **9.2 Alarmi i temperaturës**

Kur temperatura në ndarjen e ngrirjes është e ngrohtë, ndizet alarmi i temperaturës.

Tingëllon një sinjal paralajmërues, treguesi i temperaturës pulson dhe alarm ndizet.

### **⚠ KUJDES**

#### **Rrezik dëmsh në shëndet!**

Gjatë shkrires bakteret mund të shtohen dhe ushqimi në ngrirje mund të priset.

- ▶ Mos i ngrini përsëri ushqimet e ngrira që janë të shkrija pjesërisht ose plotësisht.
- ▶ Ngrijini ato sërish vetëm pas zierjes ose skuqjes.
- ▶ Mos shfrytëzoni më plotësisht periudhën maksimale të ruajtjes.

Alarmi i temperaturës mund të ndizet në rastet e mëposhtme:

- Pajisja vihet në punë.  
Futini ushqimet vetëm pasi të jetë arritur temperatura e vendosur.
- Futen sasi të mëdha ushqimi të freskët.  
Përpara futjes së sasive të mëdha të ushqimit aktivizoni Super ngrirje.
- Dera e ndarjes së ngrirjes lihet hapur për kohë shumë të gjatë.  
Kontrolloni nëse ushqimet në ngrirje kanë shkrië.

#### **Fikja e alarmit të temperaturës**

- ▶ Shtypni alarm off.
- ✓ Sinjali paralajmërues fiket.
- ✓ Treguesi i temperaturës tregon shkurtimisht temperaturën më të ngrohtë që ka qenë në ndarjen e ngrirjes. Pas kësaj, treguesi i temperaturës tregon përsëri temperaturën e vendosur.
- ✓ Nga ky moment, temperatura më e ngrohtë përcaktohet dhe regjistrohet sërish.
- ✓ alarm ndizet derisa të arrihet sërish temperatura e vendosur.

## 10 Ndarja e ngrirjes

Në ndarjen e ngrirjes ju mund të ruani ushqime të ngrira, të ngrini ushqimet tuaja dhe të prodhoni akull. Temperatura mund të vendoset nga  $-16^{\circ}\text{C}$  deri në  $-26^{\circ}\text{C}$ .

Ruajtja afatgjatë e ushqimeve duhet kryer në temperatura  $-18^{\circ}\text{C}$  ose edhe më të ulëta.

Nëpërmjet ruajtjes në ngrirje, ju mund të ruani për kohë të gjatë ushqimet që prishen. Temperaturat shumë të ulëta ngadalësojnë ose ndalojnë procesin e prishjes.

### 10.1 Kapaciteti i ngrirjes

Kapaciteti i ngrirjes tregon se çfarë sasive ushqimesh mund të ngrihet plotësisht deri në qendër dhe për sa orë.

Të dhënat për kapacitetin e ngrirjes i gjjeni në etiketën e tipit. → Fig. 11/6

### Kushtet paraprake për kapacitetin e ngrirjes

1. Rreth 24 orë përpara futjes së ushqimeve të freskëta, aktivizoni Super ngrirje.  
→ "Aktivizimi i Super ngrirje manuale", Faqe 42
2. Në fillim mbushni me ushqime ndarjen më të sipërme.
3. Kur ndarja e sipërme nuk mjafton, vendoseni sasinë e mbetur në ndarjen e poshtme.

### 10.2 Shfrytëzimi i plotë i vëllimit të ndarjes së ngrirjes

Mësoni sesi të futni në ndarjen e ngrirjes sasinë maksimale të mundshme të ushqimit për ngrirje.

1. Hiqni të gjitha pjesët e pajisjes në ndarjen e ngrirjes. → Faqe 45

2. Shtroni ushqimet direkt mbi rafte dhe mbi bazamentin e ndarjes së ngrirjes.

### 10.3 Këshilla për ruajtjen e ushqimeve në ndarjen e ngrirjes

- Vendosni në ruajtje ushqimin në paketim hermetik.
- Mos lejoni kontaktin e ushqimit të freskët për ngrirje me ushqimet e ngrira.
- Shpërndajeni ushqimin në një shtirje të madhe në koshat e ushqimeve të ngrira.
- Për të ngrirë shpejt dhe me delikatesë sasi të madhe ushqimi të freskët, vendoseni atë në koshin më të sipërm të ushqimeve të ngrira.
- Në mënyrë që ajri të qarkullojë pa pengesa nëpër pajisje, shtyjeni deri në fund koshin e ushqimeve të ngrira.

### 10.4 Këshilla për ngrirjen e ushqimit të freskët

- Vendosni në ngrirje vetëm ushqime të freskëta dhe me cilësi të përkryer.
- Ngrijini ushqimet të ndara në porcione.
- Ushqimet e përgatitura janë më të përshtatshme sesa ushqimet që konsumohen të papërgatitura.
- Përpara ngrirjes perimet duhen larë, të copëtohen dhe të përvëlohen në ujë të nxehtë.
- Përpara ngrirjes, frutat duhen larë, duhen pastruar nga bërthama dhe, sipas rastit, të qërohen dhe të shtohet sheqer dhe acid askorbik lëng.
- Ushqime të përshtatshme për ngrirje janë, për shembull, produktet për pjekje, peshku dhe

frutat e detit, mishi, kafshët dhe shpendët e egër, vezët pa lëvozhgë, djathi, gjalpi, gjiza, ushqimet e gatshme dhe mbetjet e ushqimeve.

- Ushqime të papërshtatshme për ngrirje janë, për shembull, sallata jeshile, rrepat, vezët me lëvozhgë, rrushi, mollët dhe dardhat e papërpunuara, kosi, ajka e tharët, crème fraîche dhe majoneza.

### **Paketimi i ushqimeve për ngrirje**

Materiali i përshtatshëm i paketimit dhe lloji i duhur i paketimit ruajnë në masë të konsiderueshme cilësinë e produktit dhe shmangin djegien nga ngrirja.

1. Vendosini ushqimet në paketim.
2. Nxirrni jashtë ajrin.
3. Mbyllni paketimin në mënyrë hermetike, në mënyrë që ushqimi të mos humbasë shijen ose që të mos thahet.
4. Shënoni mbi paketim përmbajtjen dhe datën e vendosjes në ngrirje.

## **10.5 Afati i ruajtjes së ushqimit të ngrirë në -18°C**

<b>Ushqimi</b>	<b>Koha e ruajtjes</b>
Peshk, sallam, ushqime të përgatitura, produkte për pjekje	deri në 6 muaj
Shpendë, mish	deri në 8 muaj
Perime, fruta	deri në 12 muaj

Kalendari i printuar i ngrirjes tregon kohën maksimale të ruajtjes në muaj në temperaturë -18°C.

## **10.6 Metodat për shkrirjen e produkteve të ngrira**

### **⚠ KUJDES**

#### **Rrezik dëmsh në shëndet!**

Gjatë shkrirjes bakteret mund të shtohen dhe ushqimi në ngrirje mund të priset.

- ▶ Mos i ngrini përsëri ushqimet e ngrira që janë të shkrira pjesërisht ose plotësisht.
- ▶ Ngrijini ato sërish vetëm pas zierjes ose skuqjes.
- ▶ Mos shfrytëzoni më plotësisht periudhën maksimale të ruajtjes.
- Shkrini në ndarjen e ftohjes ushqimet shtazore, p.sh. peshk, mish, djathë dhe gjizë.
- Shkrirjen bukën në temperaturën e ambientit.
- Përgatitni në mikrovalë, në furrë ose në sobë ushqimet për konsum të menjëhershëm.

---

## **11 Shkrirja**

### **11.1 Shkrirja në ndarjen e ngrirjes**

Në sajë të sistemit plotësisht automatik "NoFrost", ndarja e ngrirjes nuk zë akull. Shkrirja nuk është e nevojshme.

---

## **12 Pastrimi dhe kujdesi**

Në mënyrë që pajisja të qëndrojë funksionale për kohë të gjatë, pastrojeni dhe kujdesuni për të me kujdes.

Pastrimi i vendeve të paarrtshme duhet kryer nga shërbimi i klientit. Pastrimi nga shërbimi i klientit mund të ketë shpenzime.

## 12.1 Përgatitja e pajisjes për pastrimin

1. Fikni pajisjen. → *Faqe 41*
2. Shkëputni pajisjen nga rrjeti elektrik.  
Hiqni spinën e kordonit elektrik ose fikni siguresën në kutinë e siguresave.
3. Hiqni të gjitha ushqimet dhe vendosini në ruajtje në një vend të ftohtë.  
Nëse ka, vendosni mbi ushqime pllakat e ftohjes.
4. Hiqni nga pajisja të gjitha pjesët e pajimit dhe aksesorët e saj.  
→ *Faqe 45*

## 12.2 Pastrimi i pajisjes

### PARALAJMËRIM

#### Rrezik nga goditja elektrike!

Lagështia që futet brenda mund të shkaktojë goditje elektrike.

- ▶ Mos përdorni pastrues me avull ose pastrues me presion të lartë për të pastruar pajisjen.
- Futja e lëngjeve të ndriçimi ose në elementet e komandimit mund të jetë e rrezikshme.
- ▶ Uji i shpëlarjes nuk duhet të futet te ndriçimi ose tek elementet e komandimit.

### VINI RE!

Produktet e papërshtatshme të pastrimit mund të dëmtojnë sipërfaqen e pajisjes.

- ▶ Mos përdorni tela të forta ose sfungjerë të ashpër.
- ▶ Mos përdorni mjete pastrimi të mprehta ose gërryese.
- ▶ Mos përdorni produkte pastrimi që përmbajnë shumë alkool.

Kur lani në enëlarëse pjesët e pajimit ose aksesorët e pajisjes, ato mund të deformohen ose të çngjyrosen.

- ▶ Asnjëherë mos lani në enëlarëse pjesët e pajimit dhe aksesorët e pajisjes.
1. Përgatitni pajisjen për procesin e pastrimit. → *Faqe 45*
  2. Lani pajisjen, pjesët e pajimit, pjesët e aksesorëve dhe guarnicionet e dyerve me një pecetë të butë, me ujë të vakët dhe një detergjent enësh me pH neutral.
  3. Thajeni mirë më pas me një pecetë të butë e të thatë.
  4. Futni në vend pjesët e pajimit.
  5. Lidhni pajisjen me rrjetin elektrik.  
→ *Faqe 39*
  6. Ndizni pajisjen. → *Faqe 40*
  7. Vendosni përsëri brenda ushqimet.

## 12.3 Heqja e pjesëve të pajimit

Nëse dëshironi që t'i pastroni mirë pjesët e pajimit, hiqini ato nga pajisja.

### Heqja e raftit të ndarjes së ngrirjes

- ▶ Tërhiqeni jashtë raftin e ndarjes së ngrirjes dhe hiqeni.  
→ *Fig. 6*

### Heqja e koshit të ushqimeve të ngrira

1. Tërhiqeni jashtë deri në fund koshin e ushqimeve të ngrira.
2. Ngrijeni lart koshin e ushqimeve të ngrira në pjesën përpara ① dhe hiqeni ②.  
→ *Fig. 7*

### Heqja e prodhuesit të kubave të akullit

1. Tërhiqeni jashtë deri në fund koshin e ushqimeve të ngrira.

**sq** Pastrimi dhe kujdesi

2. Lironi kapëset në anën e majtë të koshit duke i shtypur njëkohësisht ① dhe hiqni prodhuesin e kubave të akullit ②.  
→ *Fig. 8*

## 13 Mënjanimi i defekteve

Defektet e lehta në pajisje mund t'i eliminoni edhe vetë. Përdorni informacionet për eliminimin e defekteve përpara se të kontaktoni me shërbimin për klientin. Kështu shmangni shpenzimet e panevojshme.

### PARALAJMËRIM

#### Rrezik nga goditja elektrike!

Riparimet e gabuara janë shkak për rreziqe.

- ▶ Riparimet në pajisje duhen kryer vetëm nga staf teknik i trajnuar për këtë qëllim.
- ▶ Për riparimin e pajisjes lejohet të përdoren vetëm pjesë këmbimi origjinale.
- ▶ Nëse dëmtohet kordoni elektrik i pajisjes, atëherë ai duhet të zëvendësohet nga prodhuesi ose shërbimi i tij për klientin ose nga një person i ngjashëm i kualifikuar, për të evituar rreziqet e mundshme.

Defekti	Shkaku dhe zgjidhja e problemeve
Pajisja nuk ftoh, treguesit dhe ndriçimi ndizen.	Është aktivizuar modaliteti i ekspozimit. <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Mbani shtypur alarm off 9 deri në 11 sekonda, derisa të tingëllojë një sinjal akustik.</li> <li>2. Kontrolloni pas një kohe të shkurtër nëse pajisja ftoh.</li> </ol>
Ndriçimi LED nuk funksionon.	Janë të mundshme shkaqe të ndryshme. <ul style="list-style-type: none"> <li>▶ Telefononi shërbimin e klientit.</li> </ul> Numrin e shërbimit të klientit e gjeni në listën shoqëruese të pikave të shërbimit të klientit.
Treguesi i temperaturës nuk ndizet.	Drita e treguesit të temperaturës është fikur. <ul style="list-style-type: none"> <li>▶ Mbani shtypur alarm off për 5 sekonda derisa të tingëllojë një sinjal akustik.</li> </ul>
Në treguesin e temperaturës shfaqet <b>E</b> ose <b>d</b> .	Sistemi elektronik ka identifikuar një gabim. <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Fikni pajisjen. → <i>Faqe 41</i></li> <li>2. Shkëputni pajisjen nga rrjeti elektrik.                Hiqni spinën e kordonit elektrik ose fikni siguresën në kutinë e siguresave.</li> <li>3. Lidhni përsëri pajisjen pas 5 minutash.</li> <li>4. Nëse mesazhi vazhdon të shfaqet përsëri në ekran, telefononi shërbimin e klientit.                Numrin e shërbimit të klientit e gjeni në listën shoqëruese të pikave të shërbimit të klientit.</li> </ol>
Tingëlton një sinjal paralajmërues, treguesi i temperaturës pulson dhe ndizet alarm.	Janë të mundshme shkaqe të ndryshme. <ul style="list-style-type: none"> <li>▶ Shtypni alarm off.</li> <li>✓ Alarmi do të fiket.</li> </ul> Dera e pajisjes është e hapur.



Defekti	Shkaku dhe zgjidhja e problemeve
Tingëllon një sinjal paralajmërues, treguesi i temperaturës pulson dhe ndizet alarm.	<p>► Mbyllni derën e pajisjes.</p> <hr/> <p>Zgavrat e jashtme të ajrimit janë mbuluar.</p> <p>► Hiqni pengesat nga zgavrat e jashtme të ajrimit.</p> <hr/> <p>Janë futur sasi të mëdha ushqimi të freskët.</p> <p>► Mos e tejkaloni kapacitetin e ngrirjes. → "Kapaciteti i ngrirjes", Faqe 43</p>
Temperatura e vendosur nuk arrihet. Shkrija plotësisht automatike nuk funksionon më.	<p>Dera e ndarjes së ngrirjes ka qenë hapur për kohë të gjatë. Serpentina (krijuesi i ftohtësisë) në sistemin "NoFrost" ka zënë shumë akull.</p> <p><b>Kërkesë:</b> Izoloni mirë ushqimet e ngrira dhe vendosini në një vend të freskët.</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Fikni pajisjen. → Faqe 41</li> <li>2. Shkëputni pajisjen nga rrjeti elektrik. Hiqni spinën e kordonit elektrik ose fikni siguresën në kutinë e siguresave.</li> <li>3. Largoni nga muri faqen e pasme të pajisjes.</li> <li>4. Hapni derën e pajisjes.</li> </ol> <p>✓ Pas rreth 20 minutash, uji i shkrires fillon të rrjedhë në tasin e avullimit në pjesën e pasme të pajisjes. → Fig. 9</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>5. Për të shmangur derdhjen e ujit nga tasi i avullimit, thitheni ujin e shkrires me sfungjer. Serpentina ka shkrire kur në tasin e avullimit nuk vjen më ujë nga shkrija.</li> <li>6. Pastroni hapësirën e brendshme të pajisjes. → Faqe 45</li> <li>7. Ndizni përsëri pajisjen. → Faqe 40</li> </ol>
Temperatura devijon shumë nga vlera e vendosur.	<p>Janë të mundshme shkaqe të ndryshme.</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Fikni pajisjen. → Faqe 41</li> <li>2. Ndizni përsëri pajisjen pas rreth 5 minutash. → Faqe 40 <ul style="list-style-type: none"> <li>– Kur temperatura është shumë e ngrohtë, kontrolloni sërish temperaturën pas disa orësh.</li> <li>– Kur temperatura është shumë e ftohtë, kontrolloni sërish temperaturën në ditën më pas.</li> </ul> </li> </ol>
Pajisja gumëzhin, fërshëllen, zukat, gurgullon, klikon ose kërcet.	<p>Nuk është defekt. Një motor është duke punuar, p.sh. grupi i ftohjes, ventilatori. Gazi i ftohjes qarkullon nëpër tuba. Motori, çelësi ose elektrovalvulat ndizen ose fiken. Kryhet shkrija automatike. Nuk është i nevojshëm asnjë veprim.</p>

<b>Defekti</b>	<b>Shkaku dhe zgjidhja e problemeve</b>
Pajisja bën zhurma.	<p>Pajisja nuk është e niveluar.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▶ Niveloni pajisjen me ndihmën e një niveli me lëng dhe të këmbëve me filetë.</li> </ul>
	<p>Pajisja nuk qëndron e lirë.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▶ Respektoni distancat minimale për pajisjen.</li> </ul>
	<p>Pjesët e pajimit lëkunden ose ngecin.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▶ Kontrolloni pjesët e heqshme të pajimit dhe vendosini ato sërish në vend.</li> </ul>
	<p>Enët prekin me njëra-tjetrën.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▶ Ndani enët nga njëra-tjetra.</li> </ul>
	<p>Është aktivizuar Super ngrirje. Nuk është i nevojshëm asnjë veprim.</p>

## 13.1 Ndërprerja e energjisë

Gjatë një ndërprerjeje të energjisë elektrike temperatura në pajisje rritet, kështu që si rezultat shkurtohet koha e ruajtjes dhe cilësia e ushqimeve të ngrira ulet.

Në seksionin e të dhënave teknike në faqen tonë të internetit do të gjeni kohën e ruajtjes së ushqimeve të ngrira në rast të një defekti.

### Shënime

- Gjatë një ndërprerjeje të energjisë elektrike hapeni mundësisht sa më rrallë pajisjen dhe mos futni brenda saj ushqime të tjera.
- Kontrolloni cilësinë e ushqimit direkt pas ndërprerjes së energjisë.
  - Hidhjeni ushqimin e ngrirë që ka shkrirë dhe është më i ngrohtë se 5°C.
  - Zieni ose skuqni ushqimin e ngrirë që ka shkrirë paksa dhe më pas konsumojeni ose vendoseni atë sërish në ngrirje.

## 13.2 Kryerja e vetëtestimit të pajisjes

1. Fikni pajisjen. → *Faqe 41*
  2. Kryeni përsëri lidhjen elektrike të pajisjes pas 5 minutash. → *Faqe 39*
  3. Brenda 10 sekondave pas ndezjes, mbani shtypur super për 3 deri në 5 sekonda, derisa të tingëllojë një sinjal akustik i dytë.
- ✓ Nis vetëtestimi i pajisjes.
  - ✓ Kur pas përfundimit të vetëtestimit të pajisjes tingëllojnë 2 sinjale akustike dhe treguesi i temperaturës tregon temperaturën e vendosur, atëherë pajisja juaj është në rregull. Pajisja kalon në funksionim normal.

- ✓ Kur pas përfundimit të vetëtestimit të pajisjes tingëllojnë 5 sinjale akustike dhe super pulson për 10 sekonda, njoftoni shërbimin e klientit.

---

## 14 Ruajtja dhe hedhja

Këtu mësoni sesi të parapërgatitni pajisjen për ta vendosur në ruajtje. Gjithashtu mësoni edhe mënyrën e hedhjes së pajisjeve të vjetra.

### 14.1 Nxjerrja e pajisjes jashtë pune

1. Fikni pajisjen. → *Faqe 41*
2. Shkëputni pajisjen nga rrjeti elektrik.  
Hiqni spinën e kordonit elektrik ose fikni siguresën në kutinë e siguresave.
3. Hiqni të gjitha ushqimet.
4. Pastroni pajisjen. → *Faqe 45*
5. Për të garantuar ajrimin e hapësirës së brendshme, lëreni pajisjen hapur.

### 14.2 Hedhja e pajisjes së vjetër

Me hedhjen e pajisjeve në mënyrë të përshtatshme për mjedisin mund të rifitohen lëndë të para të vlefshme.

#### PARALAJMËRIM

#### Rrezik dëmsh në shëndet!

- Fëmijët mund të bllokohen brenda në pajisje dhe të rrezikojnë jetën.
- ▶ Mos i hiqni raftet dhe kutitë nga pajisja për të penguar që fëmijët të futen brenda.
  - ▶ Mbani larg fëmijët nga pajisja jo në gjendje pune.

## **PARALAJMËRIM** **Rrezik zjarri!**

Nëse tubacionet janë të dëmtuara, mund të çlirohet freoni i ndezshëm dhe gaze të dëmshme e të marrin flakë.

► Mos dëmtoni izolimin dhe tubat e qarkut të freonit.

1. Shkëputni spinën e kordonit elektrik.
2. Pritni kordonin elektrik.
3. Hidhjeni pajisjen në mënyrë të përshtatshme për mjedisin.  
Informacioni për mënyrat aktuale të hedhjes mund të merret nga shitësi specialist, si dhe pranë administratës vendore të komunës ose qytetit.



Ky aparat përmban shënjën e aparaturave elektrike dhe elektroteknike sipas Udhëzimit 2012/19/EU (waste electrical and electronic equipment - WEEE).  
Udhëzimi jep kuadrin ligjor për te drejtën e kthimit mbrapsht të aparaturave të përdorura në të gjithë BE.

## **15 Shërbimi i klientit**

Nëse keni pyetje, nëse nuk mund ta eliminoni vetë një defekt në pajisje ose nëse pajisja duhet riparuar, drejtohuni te shërbimi ynë për klientin.

Informacionet e detajuara rreth periudhës së garancisë dhe kushteve të garancisë në vendin tuaj i gjeni te shërbimi ynë i klientit, shitësi juaj ose në faqen tonë të internetit.

Nëse kontaktoni shërbimin e klientit, ju nevojitet numri i produktit (E-Nr.) dhe numri i prodhimit (FD) i pajisjes suaj.

Të dhënat e kontaktit të shërbimit për klientin i gjeni në listën bashkëlidhur të pikave të shërbimit për klientin ose në faqen tonë të internetit.

### **15.1 Numri i produktit (E-Nr.) dhe numri i prodhimit (FD)**

Numrin e produktit (E-Nr.) dhe numrin e prodhimit (FD) e gjeni në tabelën e modelit të pajisjes.

→ Fig. **11/6**

Ju mund t'i mbani shënim këto të dhëna, për t'i gjetur shpejt përsëri të dhënat e pajisjes dhe numrin e telefonit të kujdesit për klientin.

## **16 Të dhëna teknike**

Lloji i gazit ftohës, vëllimi i shfrytëzueshëm dhe specifikimet e tjera teknike i gjeni në etiketën e tipit.

→ Fig. **11/6**

# Sadržaj

<b>1 Bezbednost.....</b>	<b>54</b>	<b>8 Dodatne funkcije .....</b>	<b>64</b>
1.1 Opšte napomene.....	54	8.1 Automatsko Super zamrzavanje .....	64
1.2 Namenska upotreba.....	54	8.2 Ručno Super zamrzavanje .....	64
1.3 Ograničenje kruga korisnika ....	54	<b>9 Alarm.....</b>	<b>65</b>
1.4 Bezbedan transport.....	54	9.1 Alarm za vrata .....	65
1.5 Bezbedna instalacija .....	55	9.2 Alarm za temperaturu.....	65
1.6 Bezbedna upotreba.....	56	<b>10 Pregrada za zamrzavanje.....</b>	<b>65</b>
1.7 Oštećen uređaj.....	58	10.1 Kapacitet zamrzavanja .....	65
<b>2 Izbegavanje materijalnih šteta... 60</b>		10.2 Maksimalno korišćenje za-premine pregrade za zamrzavanje .....	66
<b>3 Zaštita životne sredine i štednja .....</b>	<b>60</b>	10.3 Saveti za skladištenje namirnica u pregradi za hlađenje.....	66
3.1 Odlaganje ambalaže u otpad... 60		10.4 Saveti za zamrzavanje svežih namirnica .....	66
3.2 Štednja energije .....	60	10.5 Rok trajanja zamrznutih namirnica na -18 °C.....	67
<b>4 Postavljanje i priključivanje .....</b>	<b>61</b>	10.6 Načini odmrzavanja zamrznutih namirnica .....	67
4.1 Obim isporuke.....	61	<b>11 Odleđivanje.....</b>	<b>67</b>
4.2 Kriterijumi za mesto postavke.....	61	11.1 Odmrzavanje u pregradi za odmrzavanje .....	67
4.3 Montaža uređaja.....	61	<b>12 Čišćenje i održavanje.....</b>	<b>67</b>
4.4 Priprema uređaja za prvu upotrebu .....	62	12.1 Priprema uređaja za čišćenje.....	67
4.5 Električno priključivanje uređaja.....	62	12.2 Čišćenje uređaja .....	67
<b>5 Upoznavanje sa uređajem .....</b>	<b>62</b>	12.3 Vađenje delova opreme .....	68
5.1 Uređaj.....	62	<b>13 Otklanjanje smetnji .....</b>	<b>69</b>
5.2 Komandno polje.....	62	13.1 Nestanak struje .....	72
<b>6 Oprema .....</b>	<b>62</b>	13.2 Izvođenje samotestiranja uređaja .....	72
6.1 Uređaj za pravljenje kockica leda.....	62	<b>14 Skladištenje i odlaganje u otpad .....</b>	<b>72</b>
6.2 Pribor .....	63	14.1 Stavljanje uređaja van pogona .....	72
<b>7 Osnovno rukovanje.....</b>	<b>63</b>	14.2 Odlaganje starih uređaja u otpad .....	72
7.1 Uključivanje uređaja .....	63		
7.2 Napomene za rad.....	63		
7.3 Isključivanje uređaja.....	63		
7.4 Podešavanje temperature .....	63		
7.5 Osvetljenje prikaza temperature .....	64		

<b>15 Korisnička služba.....</b>	<b>73</b>
15.1 Broj proizvoda (E-Nr). i proizvodni broj (FD).....	73
<b>16 Tehnički podaci.....</b>	<b>73</b>



## 1 Bezbednost

Pridržavajte se sledećih sigurnosnih napomena.

### 1.1 Opšte napomene

- Pažljivo pročitajte ovo uputstvo.
- Uputstva i informacije o proizvodu sačuvajte za kasniju upotrebu ili za narednog vlasnika.
- Ukoliko postoji oštećenje nastalo tokom transporta, nemojte da priključujete uređaj.

### 1.2 Namenska upotreba

Ovaj uređaj upotrebljavajte samo:

- za zamrzavanje namirnica i pripremu kockica leda.
- u privatnom domaćinstvu i u zatvorenim prostorima kućnog okruženja.
- na nadmorskim visinama do 2000 m.

### 1.3 Ograničenje kruga korisnika

Deca od 8 godina i starija, kao i osobe sa umanjenim psihičkim, čulnim ili mentalnim sposobnostima, ili osobe bez iskustva i/ili znanja, ovaj uređaj mogu da koriste samo pod nadzorom osobe koja je odgovorna za njihovu bezbednost ili ako su obučene za bezbedno korišćenje uređaja i razumeju kakve opasnosti pri tome postoje.

Deca se ne smeju igrati uređajem.

